



REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U
PRIŠTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr.regj. 16933 /10

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDRAVAJTJE NË PRISHTINË, GJYQTARJA Fadila Hyseni me pjesmarrjen e sekretares juridike Bahrije Krasniqi , duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Shemsi Syla nga Prishtina , për kundërvajtje nga neni 16 paragrafi 1.1 të Ligjit për Deklarimin ,Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik ,e në bazë të nenit 73,74,195 dhe nenit 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 19.08.2010 merr këtë:

A K T V E N D I M

E PANDEHURA: Shemsi Nebih Syla , lindur më 1957 në fsh Bresalc KK Gjilan , tani jeton në Prishtinë në rr. Rifat berisha Bregu i diellit loku 10 nr. 10 , i martuar 6 fëmi , Antar i Bordit të RTK-së , i gjendjes së mesme ekonomike ,

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s e

Sepse deri me dt, 31.03.2010 si Zyrtar i lartë Antarë i Bordit të RTK-së , Agjencionit për antikorrupsion nuk e ka dërguar formularin për Deklarimin e Pasurisë edhe pse i janë dërguar formalët e Agjencionit për Antikorrupsion . Me qka ka kryer kundërvajtje nga neni 16 paragrafi 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik , andaj për këtë

G J O B I T E T

Me gjobë në shumën prej 1000 (një mijë) € , të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës kur ky aktvendim të merrë formë të prerë, në favor të AFQ të Drejtësisë në xhirollogarinë rrjedhëse 1000430070000518. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë, e njëjta do ti zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 30 (tridhjet) ditësh, duke llogaritur 15 (pesëmbëdhjetë) €, për një ditë burgimi. Shpenzime të procedurës nuk ka pasur, kurse në emër të paushallit gjyqsor i pandehuri është e obliguar që të paguaj shumën prej 5 € në afat dhe xhirollogari të njejtë me gjobën.

Nga një kopje e këtij aktvendimi t'i dorzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Angjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, parashtron kërkesën nr. 01/2293 /10 të dt. 08.06.2010 , për iniciimin e procedurës kundërvajtëse kundër të lartëpërmendurës dhe për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në bazë të kërkesës së parashtruar, gjyqtari inicoi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të pandehurin i cili deklaroi : se në kohën e obligimit të dërgimit të formularëve të Agjencionit për Antikorrupsion është dhënë një afat shumë i shkurt .

Me rastin e shqiptimi të denimit, gjyqtari vlerësoi të gjitha rrethanat nga neni 7 të LMK-së, nën të cilat është kryer kundërvajtja dhe të pandehurit ia shqiptoi këtë lloj denimi, duke llogaritur se edhe me këtë do të arrihet efekti i sanksionimit, që i pandehuri në të ardhmen t'i shmanget kryerjes së veprave të këtilla dhe të ngjashme.

Me sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE:Kundër këtij aktvendimi mund të parashtronjë ankesë i pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditësh pas marrjes së këtij aktvendimi, nëpërmes kësaj Gjykate dhe pa taksa.

G j y q t a r j a
Fadila Hyseni

